

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkon unifikimin e metodologjisë për publikimin e pozicioneve të reja të punës.

Në selinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një takim pune me pjesëmarrjen e Komisioneres, znj. Leterije Lleshi (Luzi) dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) z. Klevis Hysa.



Në takim u diskutua në lidhje me metodologjinë e re të publikimit të vendeve të lira të punës, për të gjithë administratën publike në përgjithësi, ku përfshihet edhe sistemi i shërbimit civil, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, ndërkohë që në praktikën aktuale publikimi realizohet përmes faqes zyrtare të AKPA-së.



Takimi u organizua duke marrë parasysh disa kërkesa/ankesa të ardhura pranë Komisionerit, nga institucione të pavarura dhe njësi të vetëqeverisjes vendore, për domosdoshmërinë e asistencës teknike në lidhje me procedurën që do të ndiqet në këtë proces të administrimit të shërbimit civil.

Gjatë takimit u diskutua për zgjidhjen e problematikave të adresuara me qëllim që të sigurohet zbatimi i unifikuar i këtij procesi, në të gjitha tipologjitë e institucioneve të sistemit të shërbimit civil dhe u darkordësua për mbledhje të përbashkëta në vijimësi, midis institucionit të

Komisionerit dhe AKPA-së, si edhe përfaqësuesve të institucioneve të pavarura dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

Kjo tipologji institucionesh është përzgjedhur për t'u përfshirë në këtë proces, duke vlerësuar se kanë më shumë nevojë për asistencë në këtë drejtim, pasi për administratën shtetërore ky proces realizohet nga DAP, që është një institucion i specializuar në këtë fushë.

Takimet do të vijojnë të zhvillohen në selinë e Komisionerit sipas një kalendari të dakordësuar nga palët.

Komisioneri vlerëson se ky moment tranzicioni, në lidhje me metodologjinë e publikimit të pozicioneve të lira dhe të gjitha njoftimeve që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, duhet të zhvillohet me kujdes, duke i asistuar institucionet, me qëllim që të mos krijohen pengesa në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

